




Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Autoriteti i Konkurrencës
Autoritet za Konkurenciju - Competition Authority



Nr. 104/2023
Datë 29.11.2023

Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës i Republikës së Kosovës në mbështetje të nenit 26, nenit 27, nenit 35, nenit 36 paragrafi 6, neni 55 paragrafi 2 nën paragrafi 2.4 i Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës Nr. 08/L-056 bazuar në kërkesën e paraqitur nga Ministria e Drejtësisë, Divizioni i Prokurimit kundër ndërmarrjes N.T.P. “Era Med” në lidhje me kufizimin e konkurrencës, abuzim me pozitë dominuese në tenderin me nr. prokurimit: 21500-23-10528-2-1-1 të Institutit të Mjekësisë Ligjore, në mbledhjen e mbajtur me datën 29.11.2023 merr këtë:

KONKLUZION

1. Me të cilën konstaton se Autoriteti i Konkurrencës, pas shqyrtimit dhe vlerësimit paraprak të situatës në tregun përkatës, nuk ka kushte për të filluar procedurën ndaj ndërmarrjes N.T.P. “Era Med” sipas nenit 36 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës Nr. 08/L-056.
2. Kushtet e hapjes së tenderit, të cilat në thelb kanë të bëjnë me të drejtën për të marrë pjesë, përkatësisht me kushtet e aftësisë së konkurrentëve, zbatimi dhe interpretimi i të cilave nuk është brenda kompetencës dhe fushëveprimit të AKRK-së, është çështje e mbikëqyrjes së organeve të administratës shtetërore/qendrore, Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP) bazuar në rregullore të veçanta që rregullojnë një çështje të caktuar, si institucioni qendror për politikën e prokurimit publik, kompetent për mbikëqyrjen administrative mbi zbatimin e Ligjit për Prokurimin Publik.

Arsyetim

Iniciativa për fillimin e procedurës:

Autoriteti i Konkurrencës me datë 08.11.2023, ka pranuar ankesë/kërkesë për kufizim të konkurrencës përmes abuzimit me pozitën dominuese/monopol në tenderin publik të Institutit për Mjekësi Ligjore.

Divizioni i Prokurimit në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë, me datë 29.09.2023, ka shpallur tender për Institutin e Mjekësisë Ligjore për shërbimet e kërkuara, procedura me titull të kontratës: Servisimi, kalibrimi dhe vertilimi i certifikuar i instrumenteve GC-MS dhe HS-GC FID të laboratorit të toksikologjisë.

Me datë 17.10.2023, është bërë hapja e ofertave dhe kemi pranuar vetëm 01 ofertë, oferta e N.T.P. Era Med. Sipas Institutit të Mjekësisë ligjore kryerësi i shërbimit duhet të jetë i autorizuar nga kompania AGILENT – USA, me arsyetimin se vetëm ajo kompani e cila është e autorizuar mund ta kryen shërbimin përfshirë edhe furnizimin me pjesë rezervë të markës AGILENT, dhe pajisjet kontabël nuk mund të përdoren.

Divizioni i Prokurimit në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë gjatë fazës së vlerësimit ka analizuar çmimet e ofruar nga të dhënat e Operatorit ekonomik të lartshënuar, ku mendon se çmimet e ofruara janë dukshëm më të larta (deri në 300%) në raport me çmimet e tregut. Produktet të cilat nuk prodhohen në Kosovë, dhe të drejtën ekskluzive e ka vetëm ky operator ekonomik, ku sipas dyshimit nga divizioni i prokurimit ky operator ekonomik ka krijuar monopol.

Të drejtën ekskluzive për ofrimin e shërbimeve, furnizimin me pajisje e ka vetëm ky operator ekonomik i cili ka ofertuar, ku edhe në të kaluarën ka pas kontratë për servisimin, mirëmbajtjen e instrumenteve.

Çmimet e larta të ofruara në disa produkte (pajisje), nëse verifikohen në internet janë dukshëm më të larta se ato të paraqitura në ofertë, në raport me çmimet e publikuara në internet në web faqen e AGILENT.

Shqyrtimi paraprak i tregut relevant dhe korniza ligjore:

1. Objektivi kryesor i politikës së konkurrencës është ruajtja e procesit konkurrues dhe nxitja e konkurrencës efektive në treg. Ruajtja ose nxitja e konkurrencës efektive është e domosdoshme, duke pasur parasysh kufizimet që sektori privat apo ai shtetëror/publik mund t'i bëjnë konkurrencës. Prandaj ligji i konkurrencës ndalon marrëveshjet për fiksimin e çmimit, abuzimin me fuqinë dominuese, si dhe përqendrimet që rrezikojnë të krijojnë një pozitë dominuese në treg.
2. Mandati themelor i AKRK-së është mbrojtja e konkurrencës së lirë dhe kjo nënkupton që AKRK vepron kur cenohet, pengohet ose shtrembërohet konkurrenca në treg. Më konkretisht, Autoriteti i Konkurrencës reagon në ato raste kur ndërmarrjet veprojnë në mënyrë të koordinuar (pra, nëse një veprim i tillë është rezultat i marrëveshjes së tyre eksplicite, përmes formës së kartelit-marrëveshjes së ndaluar apo sjelljeve të tyre në treg - praktikës së bashkërenduar). Gjithashtu, AKRK mund të reagojë edhe ndaj ndërmarrjeve që kanë pozitë dominuese në treg dhe të cilët keqpërdorin këtë pozitë.
3. Ligji i prokurimit publik është krijuar për të garantuar drejtësi, transparencë dhe konkurrencë në procesin e prokurimit që lejon përdorimin efikas dhe efektiv të fondeve publike. Këto parime janë vendosur në shumicën e ligjeve moderne të prokurimit publik dhe duhet të sigurohen nga autoritetet kontraktore. Konkurrenca efektive mund të rritet nëse një numër i mjaftueshëm ofertuesish të besueshëm janë në gjendje t'i përgjigjen ftesës për tender dhe të kenë një nxitje për të konkurruar për kontratën. Numri i ofertuesve varet shumë nga mënyra se si janë hartuar kushtet e prokurimit publik.

Meqenëse autoritetet kontraktuese duhet të stimulojnë konkurrencën midis furnitorëve potencialë për të marrë vlerën më të mirë për paranë, ato në përgjithësi duhet të hartojnë kushtet e tenderit në një mënyrë që inkurajon konkurrencën dhe lejon shumë furnizues të marrin pjesë dhe të konkurrojnë në baza të barabarta. Kjo zakonisht çon në çmime më të ulëta ose produkte ose shërbime me cilësi më të mirë. Nga ana tjetër, nëse kushtet e tenderit janë përshtatur qëllimisht për të përjashtuar furnizuesit e tjerë të mundshëm dhe për të favorizuar një furnizues specifik, kjo jo vetëm çon në çmime më të larta, por mund të jetë edhe shkelje e ligjit të prokurimit publik.

4. Mashtrimi i ofertave është një praktikë e paligjshme në të cilën palët konkurruese bashkëpunojnë për të përcaktuar fituesin e një procesi tenderimi. Mashtrimi i ofertave është një formë e marrëveshjes së fshehtë antikonkurruese dhe është një akt i manipulimit të tregut, kur ofertuesit koordinohen, ai minon procesin e ofertimit dhe mund të rezultojë në një çmim të manipuluar që është më i lartë se ai që mund të ketë rezultuar nga oferta konkurruese në tregun e lirë. Mashtrimi i ofertave mund të jetë i dëmshëm për konsumatorët dhe taksapaguesit, të cilët mund të detyrohen të përballojnë koston e çmimeve më të larta dhe kostot e prokurimit.
5. Megjithëse manipulimi i ofertës mund të marrë forma të ndryshme, një nga praktikatat më të zakonshme të manipulimit të ofertave ndodh kur kompanitë vendosin paraprakisht se kush do të fitojë një proces tenderimi. Për ta zbatuar këtë, kompanitë mund të dorëzojnë me radhë ofertën më të ulët, një kompani mund të vendosë të abstenojë nga oferta krejtësisht, ose kompanitë mund të paraqesin qëllimisht oferta jo konkurruese si një mënyrë për të manipuluar rezultatin dhe për të siguruar që ofertuesi i paracaktuar të fitojë.
6. Tenderët me një furnizues të vetëm mund të jenë rezultat i kufizimeve të ndryshme të cilat i fenojnë furnitorët potencialë për të marrë pjesë (produkt apo shërbim specifik, barriera të larta hyrjeje, kushte strikte prokurimi, etj.) ose i një karteli (ku pjesëmarrësit bien dakord që vetëm njëri prej tyre do të paraqesë një ofertë). Megjithatë, tenderët me një furnizues të vetëm mund të justifikohen objektivisht në tregje (përfshirë ato mjekësore) ku ka një numër të kufizuar furnizuesish.
7. Vlerësimi nëse çmimi është i tepërt nuk është aq i thjeshtë dhe paraqet një sërë çështjesh praktike. Së pari, nuk mjafton që çmimet të jenë të larta në raport me kostot. Është e nevojshme të kuptohet pse është kështu. Ndoshta, kompania në fjalë është angazhuar në vite të tëra kërkimi dhe zhvillimi përpara se të dalë me një produkt të caktuar (shumë i rëndësishëm në farmaceutikë) dhe një çmim i lartë është vetëm një shpërblim për ato kosto që janë bërë më parë. Prandaj, çmimi i lartë mund të jetë rezultat i një sërë rreziqesh që “përfshihen” në çmim.
8. Autoriteti ka vullnetin e plotë për të ndihmuar praktikuesit e prokurimit të zbulojnë manipulimet e ofertave që ndodhin në prokurimin publik. Manipulimet e ofertave ndodhin kur ofertuesit bien dakord ndërmjet tyre për të eliminuar konkurrencën në procesin e prokurimit, duke i mohuar publikut një çmim të drejtë. Është një marrëveshje mes konkurrentëve se kush do të jetë ofertuesi fitues. Megjithëse skemat e përdorura nga firmat për të manipuluar ofertat ndryshojnë, ato të gjitha kanë një të përbashkët,

- ofertuesit bien dakord të eliminojnë konkurrencën në mënyrë që çmimet të jenë më të lartë dhe autoritetet kontraktuese të paguajnë më shumë.
9. Autoriteti vlerëson se Ministria e Drejtësisë – Instituti i Mjekësisë Ligjore, gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit të sigurohet që operatorët të mos kufizohen nëpërmjet kushteve dhe kriterëve diskriminuese/përjashtuese. Kriteret e tilla mund të qojnë në favor të një operatori të veçantë duke i vendosur në pozita të pafavorshme konkurruese operatorët tjerë. Sigurimi i konkurrencës efikase në prokurimin publik, do t'i mundësonte ndërmarrjeve të konkurrojnë me ofertën e tyre.
10. Ndërveprimi midis politikave të konkurrencës dhe prokurimit publik është një domosdoshmëri. Ato prekin njëra-tjetrën për nevojën për të trajtuar praktikatat antikonkurruese ose manipulimin e ofertave të tenderët publik.
11. Nga sa më lartë, Komisioni i Autoritetit duke u bazuar në nenin 55 paragrafi 2 nën paragrafi 2.4 i Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, u vendos si në dispozitiv të këtij Konkluzioni.

Obligohet Sekretariati që të kujdeset për zbatimin e këtij konkluzioni.

Ky konkluzion, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana Komisionit.

AUTORITETI I KONKURRENCËS
Komisioni

Neime Binaku - Isufi
Kryetare

Kaltrina Sela
Nënkryetare

Florent Mehmeti
Anëtar

Nafije Osdautaj
Anëtare

Salihe Gashi Loku
Anëtare

Këshilla juridike: Kundër këtij konkluzioni nuk është e lejuar ankesa por pala me padi mund të iniciojë konflikt administrativ pranë Gjykatës kompetente për çështje administrative.

Me këtë KONKLuzion të njoftohen:

- Pala ankuese (Ministria e Drejtësisë)
- Publikohet në web faqen e Autoritetit
- Arhiva